

dy fjalë për interunido-n

interunido është qendra kryesore profesionale-arësimore në fushën e migrimit dhe të integrimit në regjionin Langenthal dhe Oberaargau.

interunido është e pavarur në aspektin konfesional dhe politik. Oferatat e sajë nuk kanë orientim fitimprurës. Vepron nën patronatin e Shoqatës për mbështetjen e arësimit dhe të integrimit në Oberaargau (BIO).

Fushëveprimtaria: Arësimimi, ndërmjetësimi interkulturore, këshillimi

Oferatat e interunido ndihmohen materialisht nga Drejtoria për Edukim e Kantonit të Bern-it, nga Enti Federal për Migracion (BFM), nga Qyteti Langenthal, „Logis Suisse“ dhe të tjerë.

Oferatat arësimore janë të çertifikuara nga eduQua.

ofertat

Arësimimi

Kurse të ndryshme dhe tubime informative për persona me gjuhë të huaja dhe për profesionistë.

Ofertë e gjërë e kurseve të gjermanishtes:

- Mësim në nivele të ndryshme. Seleksionimi bëhet pas testimit adekuat.
- Mbështetje individuale në grupe të vogla
- Mësim i përshtatur nevojave dhe shpejtësisë së të mësuarit
- Gjermanisht për nëna dhe fëmijë(fëmijët prej 3 - 5 vjeç, pregaditje për në çerdhe)
- Mësuese kompetente dhe me përvojë
- Çmime të lira

Projekte

Ofertë në tema të ndryshme si për shembull:

- Përkrahje e hershme për fëmijët
- Ndihmë në zgjidhjen e detyrave
- Çështjet e edukimit
- Takim dhe shkëmbim mendimesh dhe përvojash
- Të banosh në lagje („Quartier“)

Ndërmjetësim interkulturore dhe përkthime

- Ndërmjetësueset/ndërmjetësuesit kulturorë ndërmjetësojnë/përkthejnë në 13 gjuhë të ndryshme (vetëm gojarisht)
- Shërbimi i përkthimeve me telefon në raste urgjente
- Projekte interkulturore

Këshillim

Informata për të gjithë personat dhe entet në temën migrimi dhe integrimi. Temat:

- Shkolla dhe edukimi
- Arësimimi i mëtejshëm, kurse të gjuhës dhe për integrim
- Çështjet sociale dhe shëndetësore
- Qendra profesionale dhe persona të specializuar
- Punë
- Çështje juridike
- Ndërmjetësim dhe përkthim interkulturore
- Këshillime për projekte

plani

Vendndodhja e zyrave dhe e kurseve intenzive të gjermanishtes

Udhëpërshkrimi prej stacionit të trenit në Langenthal:

Autobusi Nr.14 drejtimi "Dennli" deri ke stacioni "Bahnhof Süd" (rreth 8 minuta). 5 minuta në këmbë deri tek interunido. Përballë fabrikës së „Pommes-frites” "Kadi", në lagjen e madhe (ndërtesat e bardha dhe të kaltëra të çelë).

Vendi ku mbahen kurset për nënat dhe fëmijët („MuKi-Deutsch“)

Udhëpërshkrimi:

Kërkojeni kullën e madhe të kishës katolike. Çerdhja e fëmijëve „Talstrasse” është në ndërtesën e madhe të shkollës përballë kullës, Talstrasse Nr. 28. Në këmbë prej hallës së sporteve „Kreuzfeld” rreth 5 minuta, ndërkaq nga stacioni i trenit 15 minuta.